



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Primjenol/Prodato Received/Delivery	06.07.2023	viti god year	3
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKAMSHICK	5083/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A/02/159/2016

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit AA.nr.270/2019 të datës 20.05.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovë dhe Aktgjykimit A.nr.1068/16 të datës 20.01.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A/02/159/2016 të datës 25.04.2016 të parashtruar nga ankuesi adresë banimi: kundër

Vendimit të datës 23.03.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Kundër Korrupsionit, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A/02/159/2016 e datës 25.04.2016 e parashtruar nga ankuesi e cila është rishqyrtuar sipas Aktgjykimit AA.nr.270/2019 të datës 20.05.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovë dhe Aktgjykimit A.nr.1068/16 të datës 20.01.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative

II. Anullohet Vendimi me numër 01-01/1220/16 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa i datës 23.03.2016.

III. Ndryshohet Formulari i Vlerësimit të Rezultateve në Punë i datës 18.01.2016, ashtu që Nota e Përgjithshme e Vlerësimit mbetet e njëjtë, ndërsa komentet e kontestuara në këtë ankesë largohen.

IV. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kundër Korrupsionit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, i pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2015 ka parashtruar ankesë me datë 22.06.2016 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa me datë 23.03.2016 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nxjerr vendimin me numër:01-01-1220/16 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit, ndërsa e ka lënë në fuqi formularin e vlerësimin e rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2015 i datës 18.01.2016.

Ankuesi, i pakënaqur me vendimin me numër:01-01/1220/16 të datës 23.03.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 25.04.2016 dhe numër protokolli 1591/2016.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 20.06.2016 ka nxjerr Vendimin numër A/02/159/2016 dhe numër protokolli 2472/2016 me të cilin e ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit të datës 25.04.2016. Ankuesi kundër Vendimit të Këshillit me numër A/02/159/2016 ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 14.07.2016.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 22.01.2019 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.1068/16 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit ndërsa ka anuluar vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A/02/159/2016 të datës 20.06.2016, ndërsa lëndën e ka kthyer në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Aktgjykimit A.nr. 1068/16 të datës 22.01.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me datë 13.02.2019 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Gjykata e Apelit të Kosovës me datë 20.05.2020 ka nxjerr Aktgjykimin me AA.nr.270/2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 13.02.2019, ndërsa Aktgjykimin A.nr.1068/16 të datës 22.01.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative e ka vërtetuar.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e përsëritur të ankuesit të datës 26.08.2022, në mbështetje të Aktgjykimin me AA.nr.270/2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, i cili Aktgjykim është i plotfuqishëm edhe përfundimtarë

ndërlidhur me këtë procedurë administrative dhe meqë ka konstatuar lëshimin me rastin e vendimmarrjes së parë nga ana e Këshillit, ndërsa në bazë të vërejtjeve të dhëna nga Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative dhe konfirmimit edhe nga Gjykatat e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, bazuar në nenin 81 paragrafi 2 si dhe nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshilli me datë 25.04.2022 është parashtruar brenda afateve kohor prej 30 (ditësh), ndërsa Kolegji i Këshillit është lëshuar në shqyrtim merititor të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin AA.nr.270/2019 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative i datës 20.05.2022; Ankesën e Këshillit të parashtruar në Gjykatën e Apelit të Kosovës me datë 12.02.2019; Aktgjykimin AA.nr.1068/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 22.01.2019; Procesverbalin e datës 22.01.2019 me numër A.1068/2016; Procesverbalin e datës 18.12.2018 me numër A.1068/2016; Autorizimin e datës 17.12.2018; Ftesën e datës 14.11.2018; Përgjigjen në padi të datës 20.12.2017; Aktvendimin A.nr.1068/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 16.11.2017; Padinë e datës 24.07.2016; Vendimin e Këshillit A/02/159/2016 të datës 20.06.2016; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 25.04.2016; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë 19.01.2015; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë 14.01.2015; Njoftimin e datës 20.01.2016 me numër:01-251/16; Kërkesën për ri-shqyrtim të vlerësimit e datës 19.12.2015; Shkresën "Raporti i Lëndëve në Procedurë dhe të përfunduara në vitin 2015"; Shkresën "tabela e shkresave të realizuara gjatë vitit 2015" e datës 21.12.2015; Ankesën e ankuesit e parashtruar në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave e datës 22.02.2016; Vendimin e datës 23.03.2016 të Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mailin e datës 14.06.2016 dërguar nga për Njoftimin e datës 16.06.2016; Përgjigjen në kërkesë të datës 05.05.2016 me shkresat e bashkangjitura të lëndës; E-mailin e datës 23.03.2016 dërguar nga Sh. K për S.J; E-mailin e datës 01.03.2016 dërguar nga për Procesverbalin e datës 29.02.2016; E-mailin e datës 29.03.2016 dërguar nga për Shkresën e datës 09.03.2016 "ofrimi i dëshmive"; E-mailin e datës 16.12.2015 dërguar nga për E-mailin e datës 26.02.2016 dërguar nga për E-mailin e datës 26.02.2016 dërguar nga për Listën e vijueshmërisë në punë e datës 14.01.2016; E-mailin e datës 26.06.2015 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej katër (4) faqesh; E-mailin e datës 01.07.2015 dërguar nga për korrespondencën e bashkangjitur prej katër (4) faqesh; E-mailin e datës 31.07.2015 dërguar nga për korrespondencën e bashkangjitur prej 6 (gjashtë) faqesh; E-mailin e datës 30.06.2015 nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Opinionin e lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit e datës 31.07.2015; Raportin e datës 31.07.2015; Raportin zyrtar për parandalim i periudhës 06.05.2015-17.06.2015; E-mailin e datës 31.07.2015 dërguar nga ankuesi për Kërkesën për pushim e datës 28.07.2015; Raportin zyrtar për parandalim i datës 14.05.2015; Raportin e datës 07.08.2015 me referencë DPK-DPKRP-03-03-1699/15; Opinionin e datës 07.08.2015 me numër:01-2356/15; E-mailin e datës 14.07.2015 dërguar nga ankuesi për E-mailin e datës 15.07.2015 dërguar nga ankuesi për E-mailin e datës 16.07.2015 dërguar nga ankuesi për E-mailin e datës 12.08 E-mailin

e datës 14.07.2015 dërguar nga ankuesi për E-mailin e datës 12.08.2015 dërguar nga ankuesi për ; E-mailin e datës 15.06.2015 dërguar nga ankuesi për ; E-mailin e datës 01.10.2015 dërguar nga për ankuesi; E-mailin e datës 05.05.2015 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 19.12.2015 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej 4 faqesh; E-mailin e datës 07.03.2015 dërguar nga për ; E-mailin e datës 04.02.2015 dërguar nga për ankuesin; Raportin mujor te punës i datës 01.04.2015; Raportin mujor te punës i datës 05.03.2015; Raportin e punës i periudhës 01.02.2015-28.02.2015; Raportin e punës për muajin shkurt i datës 05.03.2015; Raportin e punës i datës 05.03.2015; Raporti mujor i punës "Parandalimi i Korrupsionit në prokurimin Publik"; Vendimin e datës 02.03.2015 lëshuar nga Drejtori i Departamenti për parandalimin e Korrupsionit i AKK; Shkresën e datës 17.12.2015 me numër reference 03-03/ 585/15; Rregulloren Nr.01/2014 e Punës në AKK; Kërkesën për rishqyrtim të vlerësimit e datës 19.12.2015; Njoftimin e datës 21.01.2016 me numër 01-251/16.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lëndës, në kohën e parashtrimit të ankesës në Këshilli, ankuesi ka mbajtur pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Parandalimin e Korrupsionit", ndërsa udhëheqësja e drejtpërdrejtë për periudhën kohore prej datës 01.01.2015 deri me datë 31.12.2015, përmes Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të datës 18.01.2016, e kishte vlerësuar si vijon: Notë mesatare për objektivat: 4.5 dhe notë mesatare për aftësitë: 3.2, **ndërsa notë të përgjithshme: 3.98.**

Ankuesi, i pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kundër Korrupsionit me kërkesën për ri-shqyrtimin të vlerësimit të rezultateve në punë, ndërsa Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kundër Korrupsionit përmes shkresës së datës 20.01.2016 e njofton ankuesin se kërkesa e tij vlerësohet e pabazuar duke e udhëzuar të njëjtin të parashtrojë ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Me datë 22.06.2016 ankuesi parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të datës 18.01.2016, ndërsa Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave përmes vendimit me numër: 01-01/1220/16 të datës 23.03.2016 ka refuzuar ankesën e ankuesit, ndërsa e ka lënë në fuqi formularin e vlerësimit e rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2015 i datës 18.01.2016.

Ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vlerësimi i rezultateve në punë nga Udhëheqësi i tij i Drejtpërdrejtë është bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores 19/2012 për Vlerësimin e rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, pasi që ankuesi nuk ishte njoftuar paraprakisht lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë deri në ditën e vlerësimit me datë 18.01.2016 sikurse komentet e vlerësimit ndërlidhur me objektivat janë në kundërshtim me natyrën e

vlerësimit, ndërsa Vendimi numër: 01-01/1220/16 i datës 23.03.2016 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe është i kundërligjshëm pasi që e ka lënë në fuqi Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të datës 18.01.2016.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit e ka analizuar përmbajtjen e komenteve për vlerësimin e objektivave të specifikuar tek Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të datës 18.01.2016, *citoj*: *"Komentet e mia do t'i bëjë për dy raste të cilat më duhet t'i paraqes dhe pres të sqarohen në procedurë të mëtutjeshme: Rasti i parë ka të bëjë me aktivitetin në MKRS në cilën kam qenë e detyruar që të mos nënshkruaj këto dokumente zyrtare: Pushimin Vjetor (ku zyrtari ka pas ankesa se qëllimisht nuk po i nënshkruaj pushimin) pa përfunduar detyrën ashtu si e kam vlerësuar se duhet kryer. Raportin për mbyllje dhe mos procedoj opinionin për nënshkrim pasi kam vlerësuar se nuk është vlerësuar në detal. Pse në detal sepse ka kërkuar të paraqitet çdo veprim i autoritetit me të vetmin qëllim të vërtetohet e vërteta për dy anët, në këtë ne jemi akuzuar me shkrim të cilat akuza ishin shpërndarë me të madhe të tërë MKRS dhe tek ne në AKK, Rasti i dytë ka të bëjëj*", po ashtu ka analizuar dispozitat e Rregulloren Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 ku përcaktohet se: *"Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim: 1.5 Periudha e vlerësimit, nënkupton periudhën gjatë së cilës kryhet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë dhe zgjat nga 1-31 dhjetor të vitit të vlerësuar"*, neni 7 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1; 2.4 dhe 2.5 i së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Objektivat dhe aftësitë vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati final i vlerësimit llogaritet sipas mesatares së fituar dhe pasqyrohet si vijon: Nga 1 deri më pak se 1.5 nënkupton "dobët", Nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë"; dhe Nga 4.5 deri në 5 nënkupton "shkëlqyeshëm"; si dhe neni 10 paragrafi 2i së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: "Për çdo objektiv apo aftësi të nëpunësit civil të vlerësuar me notat 1, 4 dhe 5, vlerësuesi duhet të arsyetojë vendimin e tij, përmes plotësimit të pjesës së komenteve në formularin e vlerësimit"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatimit të gjendjes faktike, analizimit të pretendimeve ankimore të ankuesit të paraqitura në ankesën e datës 25.04.2016 si dhe analizimit të dispozitave të ligjit material të aplikuar në kohën e inicimit të procedurave ankimore, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, ngase udhëheqësja e tij e drejtpërdrejtë fillimisht ka dështuar të realizojë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2015 për ankuesin brenda afatit kohor të përcaktuar si në neni 3 paragrafi 1 në paragrafi 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil ngase sipas kësaj rregulle vlerësimi është dashur të kryhet më së largu deri me datë 31.12.2015, ndërsa vlerësimi i ankuesit është bërë tek me datë 18.01.2016, po ashtu ndërlidhur me komentet e dhëna në Formularin e Vlerësimit të Rezultateve të Punës të datës 18.01.2016 të evidentuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi janë në kundërshtim me frymën e normës, respektivisht në kundërshtim me përcaktimet e neni 10 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil ngase komentet e për vlerësimin me notat 1, 4 apo 5 duhet të shërbejnë si arsyetim për nivelin e vlerësimit, pra duhet të arsyetohet fakti se pse i vlerësuar është vlerësuar me notën 1 "dobët" apo cilat kanë qenë arsyet dhe veprimet që kanë bërë të vlerësohet dobët, apo pse i njëjti është vlerësuar me 4 "shumë mirë" dhe 5 "shkëlqyeshëm" dhe se cilat kanë qenë të arriturat e tij dhe performancë në punë gjatë vitit, ndërsa komentet e dhëna nga udhëheqësja ishin e

kundërta e përcaktimit të kësaj norme, ngase në kuptim të nenit 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: " Kuptimi i notave në paragrafin 2 të këtij neni është si në vijim 3.1. *"shkëlqyeshëm"*, vlerësohen nëpunësit civil, të cilët jo vetëm i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve), por kanë treguar edhe aftësi dhe cilësi të punës, që tejkalon shumë pritjet. Po ashtu ata që kanë kontribuar thellësisht në realizimin e objektivave të njësisë organizative, gjegjësisht të institucionit. 2. *"shumë mirë"*, vlerësohen nëpunësit civil, të cilët jo vetëm i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të të gjitha aktiviteteve), por kanë treguar aftësi dhe cilësi të punës, që tejkalon pritjet, kanë kontribuar në realizimin e objektivave të njësisë organizative" ankuesi për arritjen e objektivave ishte vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare me 4.5 apo *"shkëlqyeshëm"* duke lënë të kuptohet që i njëjti jo vetëm si i ka arritur të gjitha objektivat por i tejkalon pritjet, ndërsa përmbajta e komenteve janë në frymën e mos arritjes së përmbushjes së detyrave të punës nga ana e ankuesit, andaj mbi këtë bazë pretendimet ankimore për këtë çështje janë të bazuara.

Ndërlidhur me pretendimin ankimore të ankuesit se vlerësimi i vitit paraprak, respektivisht i vitit 2014 është më i lartë sesa i vitit 2015 dhe kjo çështje paraqet mospërputhshmëri dhe standardizim të shumëfishtë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ky pretendim është i pa bazuar ngase vlerësimet për vitin kalendarik janë të ndara nga vitet paraprake dhe në këtë frymë edhe sipas nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullores Nr. 19/2012 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: "Për qëllime të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim: 1.5 *Periudha e vlerësimit*, nënkupton periudhën gjatë së cilës kryhet procedura e vlerësimit të rezultateve në punë dhe zgjat nga 1-31 dhjetor të vitit të vlerësuar" ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i së njëjtës rregullore që përcakton se: "Vlerësimi i rezultateve të punës, nënkupton procesin e vlerësimit të realizimit të objektivave të punës për çdo nëpunës civil dhe vlerësimin e aftësive të nëpunësit civil, që kanë shërbyer në arritjen e objektivave" jo domosdoshmërisht vlerësimet duhet të jenë identike apo të njëjta me vitet paraprake, andaj në këtë kuptim Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankesa e ankuesit është aprovuar pjesërisht si në dispozitiv të këtij vendimi duke i ndryshuar Formularin e Vlerësimit të rezultateve në punës i datës 18.01.2016 ku pjesa e komenteve hiqen dhe të njëjtat nuk prodhojnë asnjë efekt ndaj ankuesit, ndërsa nota e përgjithshme e vlerësimit prej 3.8 *"shumë mirë"* mbetet e pa ndryshuar respektivisht pretendimi ankimor i ankuesit se vlerësimi i vitit 2014 është më i lartë sesa i vitit 2015 dhe kjo çështje paraqit mospërputhshmëri dhe standardizim të shumëfishtë është i paqëndrueshëm dhe nuk mund të përbëjë arsye që secilin vit vlerësimi duhet të jetë i njëjtë.

Po ashtu, Kolegji i Këshillin mbi bazën e këtyre të gjeturave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa me rastin e nxjerrjes së vendimit të datës 23.03.2016 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 22.02.2016 ndërsa ka lënë në fuqi ashtu siç ka qenë Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 18.01.2016 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, andaj mbi këtë bazë në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.5. është në kundërshtim me ligjin material" dhe meqenëse nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike ndërlidhur me rastin dhe

mënyrën e vlerësimit të ankuesit, në kuptim të nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: "Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj", Vendimi me numër 01-01/1220/16 i Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa i datës 23.03.2016 është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi me qëllim të kthimit të ligjshmërisë.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A/02/159/2016

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së